



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim, THEMELOHET, Këshilli Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara në Lipjan, në këtë përbërje:

- 1.Gjyste Dabaj , Kryesuese e Këshillit
- 2.Hasan Luma , Zëvendëskryesues i këshillit
3. Albert Mustafa, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
- 4.Arjeta Thaqi Stublla, Shtëpia e komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore –ngecje në zhvillim mendor, anëtare
- 5.Afrim Mena OJQ- Handikos, anëtar
- 6.Fahrije LLugiqi, OJQ-OMPAKL, anëtar
- 7.Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
- 8.Selman Jashanica,Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
- 9.Lidija Jovanoviq, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
- 10.Behar Amrllahu, Qendra për Punë Sociale, anëtar
- 11.Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2

Këshilli Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara ka për qëllim që të angazhohet për krijimin e mundësive të barabarta, përmirësimin e kushteve të jetës për personat me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit, punësimit, shërbimet ndihmëse dhe jetesës pa pengesa, parandalimin e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe procesit të krijimit të politikave të gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke përditësuar kulturën e respektimit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të personave me aftësi të kufizuara, dhe të sigurojë që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara të merren gjithmonë parasysh dhe me prioritet, çdo herë kur Komuna e Lipjanit merr vendim për çështjet që mund të kenë ndikim në gjendjen e personave me aftësi të kufizuara.

Takimet e Këshillit i udhëheq Kryesuesia e Këshillit Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara e cekur në numrin rendor 1 e në rast të mungesës së saj do të udhëhiqen nga zëvendësuesi i kryesueses i cekur në numrin rendor 2.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtorati për Administratë-Njësiti për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

1Nr. 020/04-52794
Lipjan, më 30.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

